



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:220211
Datë: 16.07.2024
Numri i dokumentit: 05944083

PPP.nr.48/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridike të përmbarrimit, sipas propozimit për përmbarrim të kreditores së përmbarrimit K me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër debitorit të përmbarrimit M (H) F nga fshati Guri i Kuq, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati L.V nga Prishtina për përmbarrimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 1.443.02 euro, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me energji elektrike, lejuar me urdhrin për përmbarrim, P.nr.75/20 të datës 03.02.2020, të përmbarruesit privat G.Gj nga Gjakova duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të përmbarrimit, jashtë seancës gjyqësore, më datë 16.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit të përmbarrimit M (H) F nga fshati Guri i Kuq, Komuna e Rahovecit, ushtruar kundër urdhrin për përmbarrim, P.nr.75/20 të datës 03.02.2020, të përmbarruesit privat, G.Gj nga Gjakova, dhe mbetet në fuqi i njëjti urdhër për përmbarrim.

A r s y e t i m

Organi i përmbarrimit, përmbarruesi privat G.Gj nga Gjakova me urdhrin për përmbarrim, P.nr.75/20 të datës 03.02.2020, ka lejuar propozimin për përmbarrim të kreditores së përmbarrimit, K me seli në Prishtinë, të paraqitur kundë M (H) F nga fshati Guri i Kuq, Komuna e Rahovecit, për përmbarrimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 1.443.02 euro, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me energji elektrike.

Kundër këtij urdhri për përmbarrim, pas pranimit të tij, përfaqësuesi i autorizuar i debitori M.H.F, avokati L.V, ka ushtruar prapësim, në të cilën në të tjera ka deklaruar se debitori me datë

28.01.2020, ka pranuar faturën me nr. 8306482, ku sipas kësaj fature debitori kreditore i ka borxh 120,20 euro, ku 56,39 euro i ka borxh ndaj K-sit për muajin janar 2020, ndërsa 69.01 euro i ka borxh ndaj K-ut. Po ashtu ka deklaruar se kreditori dhe debitori kanë arritur marrëveshje bërë faljen e borxhit por kjo marrëveshje nuk ka titull ekzekutiv duke shtuar se sipas dispozitave ligjore shërbimet shpenzimeve komunale për furnizim me energji elektrike vjetërsohen me kalimin e afatit prej një (1) viti. Andaj ka kërkuar nga gjykata të anuloj urdhërin përmbarimorë dhe ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Pas pranimit të prapësimit nga pala debitorë, pala kreditore K me seli në Prishtinë, ka parashtruar përgjigje në prapësim, sipas së cilës përmbarimi është kërkuar nga dokumenti i besueshëm-ekstraktit nga librat e kontabilitetit, duke shtuar se debitori ka lidhur marrëveshje për faljen e borxheve por të njëjtën nuk e ka zbatuar në tërësi, pasi që i njëjti ka paguar 16 këste nga data 28.08.2017 e deri më 07.10.2019, dhe më pas ka ndërprerë pagesën me që rast i është kthyer borxhi i falur duke iu minusuar këstet e paguar. Andaj ka kërkuar që prapësimin e debitorit gjykata ta refuzoi.

Në vazhdim, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit, ushtruar kundër urdhrit për përmbarim, P.nr.75/20 të datës 03.02.2020, të përmbaruesit privat G.Gj , është i pabazuar.

Sa i përket dokumentit përmbarimor, gjykata erdhi në përfundim se kreditorja e përmbarimit, propozimin për përmbarim e ka bërë sipas dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga librat e kontabilitetit, 1.443.02 euro, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me energji elektrike. Pra, dokumenti mbi të cilin pala kreditore e mbështet propozimin për përmbarim përbën dokument të besueshëm, në përputhje me nenin 29 par. 1. të LPP-së, sipas të cilës dispozitë ligjore shprehimisht theksohet se *“përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* ndërsa, 1.2. *ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave;”*..

Sipas LPP-së nenit 27 par.1 përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Nga kjo rezulton se vendimi në fjalë është titull përmbarimor për shkak se e ka të përcaktuar kreditoren dhe debitorin, kohën e përmbushjes së detyrimit, si dhe shumën e përmbushjes, andaj si i tillë është i përshtatshme për përmbarim.

Më tej, gjykata ka vlerësuar pretendimin debitorit dhënë në prapësim, se kërkesa e palës kreditore për detyrimin në të holla, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me energji elektrike është parashkruar, mirëpo erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është i pabazuar dhe nuk qëndron.

Kështu, në nenin 360 par. 1 pika 1.1. të LMD-së, përcaktohet që *“kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake, parashkruhen pas një (1) viti”*. Në rastin konkret, sipas vlerësimit të kësaj gjykate

është me rëndësi të theksohet se në nenin 368 të LMD-së parashihet që *“parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*. Në rastin konkret, në bazë kontratës për faljen e borxhit të kreditorit të përmbarimit që i ka bashkëngjitur në shkresat e lëndës del se debitori i përmbarimit më datën 12.06.2016, ka bërë marrëveshje për pagesën e borxhit, ndërsa nga ekstraktit nga librat e kontabilitetit vërehet se i njëjti ka bërë pagesën në 16, këste në shumës nga 42.00 euro, në emër të borxhit në llogarinë e kreditorit nga data 12.06.2016, e deri me datë 21.08.2019. Në rastin konkret, propozimi për përmbarim është ushtruar më datën 03.02.2020. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, me vetë faktin e pagesës së kryer nga debitori i përmbarimit tek kreditori i përmbarimit, me anë të kësaj pagese kemi ndërprerjen e afatit të parashkrimit, prandaj edhe ka vendosur ta refuzojë në tërësi prapësimin e debitorit të përmbarimit.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pa bazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së. Debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova, sipas nenit 69 par. 4 të LPP-së, i cili parasheh që *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, për ndryshe prapësimi do të refuzohet”*.

Andaj nga të cekurat më lartë, e në kuptim të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.48/2020 më datën 16.07.2024

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate Themelore.